



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:242589

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06376704

**P.nr.316/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, në përbërje prej Gjyqtares së vetme gjykuese Benita Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.H.nga fshati R. rruga "Y. e Xh." K. Gjakovë, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4296/2024, të datës 05.09.2024, për shkak se në vazhdimsi ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik me datën 20.09.2024, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Paulin Pashku, të pandehurit D. H. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Arian Hetemi, si dhe të dëmtuarës E. O., me datën 23.09.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa, me datë 18.10.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit:

**D. H.** nga i ati R., e ëma R., e gjinisë Sh., i lindur me *data e lindjes...*, në Gjakovë, tani me banim në fshatin R. rr. "Y. e Xh." K. Gjakovë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, ka të kryer vitin e parë të shkollës së mesme, me numër personal *numri...* shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**SEPSE:**

Më parë e në vazhdimësi deri më datë 02.09.2024, në periudha të ndryshme kohore, i pandehuri D. H. me dashje që ti shkaktojë ndjenjën e frikës dhe të pasigurisë për jetë seriozisht e ka kanosur me fjalë tani të dëmtuarën E. O. në atë mënyrë që përmes rrjetit social Whatsup përmes numrit ... i ishte drejtuar me fjalë të ndryshme si, "kam me të hi brenda në shtëpi me ju vra, ka me ju shkru vëllezërve të tu që na dy jena kanë bashkë dhe ka me ja dërgu të gjitha fotot e tua që i kam, kam me ta ndalu punën, ti nuk guxon me u martu me askënd dhe ki me met qashtu" e shumë fjalë të tjera kërcënuese me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe të pasigurisë për jetë,-

-me këtë në vazhdimsi ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 79 dhe nenit 181 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 365, 449, 452 dhe 460 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Të pandehurit D. H., i përcakton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej **4** (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej **1** (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet. Në rast të revokimit të dënimit me

kusht, në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet koha e kaluar në masën e ndalimit nga data 03.09.2024 deri me datën 05.09.2024.

**OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate, të ia paguaj shumën prej 20-€ dhe shumën prej 20.-€ në Fondin e Viktimave të krimin, këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**E dëmtuara:** E. O. nga fshati V. e G., Rr. "B." K. Lipjan, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

Ndaj të pandehurit D.H., gjykata me aktvendim të veçantë ka ndërprerë masën e ndalimit për t'iu ofruar vendit dhe personit të caktuar.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4296/2024, të datës 05.09.2024, me kërkesë për caktimin e masës ndalimi për t'iu ofruar vendit dhe personit të caktuar, ndaj pandehurit D. H., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Fillimisht gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore me datë 05.09.2024, në të cilën seancë Prokurori i shtetit Paulin Pashku ka bërë precizimin e aktakuzës në cilësimin juridik në dispozitivin e kërkesës duke shtuar fjalën në vazhdimësi nga neni 77 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur e pandryshuar. Të pandehurit iu është caktuar masa e ndalimit për t'iu ofruar vendit dhe personit të caktuar në kohëzgjatje prej një (1) muaj.

Me datë 20.09.2024 gjykata ka cakuar dhe mbajtur seancën fillestare në të cilën kanë prezentuar Prokurori i shtetit Paulin Pashku, i pandehuri D. H. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Arian Hetemi si dhe e dëmtuara E. O..

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se, e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit shtoi se është penduar për veprën penale të kryer, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar, dhe i ka premtuar të njëjtit se në të ardhmen nuk do ta shqetësoj më asnjëherë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, si dhe i ka propozuar gjykatës që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse ky pranim i fajësisë është vullnetar, është i sinqert, dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës e të cilat janë: deklarimi i të dëmtuarës në polici, deklarimi i të pandehurit në polici, dhe foto albumi i lëndës dhe përmbajtja e mesazheve telefonike, të cilat ndërlidhen me njëra tjetrën andaj i ka propozuar gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa sa i përket masës i njëjti deklaroi se pas deklarimit të palës së dëmtuar, si dhe duke e marrë parasysh propozimin e avokatit mbrojtës për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar, si dhe deklarimin e palës se dëmtuar e cila fare qartë deklaroi se nuk e ndien veten të rrezikuar nga i pandehuri konsideroi se kanë pushuar kushtet ligjore për vazhdimin e kësaj mase andaj i propozojm gjykatës që këtë masë ta ndërprej.

E dëmtuara në shqyrtimin fillestar me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, dhe ia fali dhe se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, kërkoi që i njëjti mos të dënohet por që të mos i pengoj dhe ta vazhdoj jetën e tij, dhe shtoi se nuk e ndien veten të kërcënuar nga i pandehuri dhe i propozoi gjykatës që të pandehurit t'i ndërprehet masa e caktuar pasi që nuk ndjehet e rrezikuar nga i njëjti.

Mbrojtësi i të pandehurit, av.Arian Hetemi, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, pas konsultimeve paraprake që ka pasur me të mbrojturin e tij, i njëjti në mënyrë vullnetare

pa presion ka pranuar fajësinë dhe njëherit palës së dëmtuar i ka kërkuar falje duke premtuar se nuk do të përsëris një veprë të tillë penale si dhe njëherit ndjen keqardhje për rastin, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana konsideroj se me rastin konkret kemi të bëjmë me rrethana lehtësuese e veçanërisht lehtësuese se i njëjti ka vepruar në afekt mendor dhe në rastin konkret është për veprën që i vihet në barrë andaj gjykatës i propozoi që me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të matjes së dënimit pasi që edhe pala e dëmtuar nuk iu bashkangjiti ndjekjes penale dhe kërkoi që i njëjti të mos dënohet, prandaj gjykatës i propozojmë që ndaj të pandehurit t'i shqiptoi një dënim me kusht e nëse i shqipton një dënim me burgim efektiv të njëjtit t'i mundësohet dhënia e pëlqimit që dënimi me burgim t'i zëvendësohet me dënim me gjobë. Andaj i propozoi gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të ndërprehet masa e ndalimit për tu afruar.

Gjyqtarja e vetme gjyquese pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptur natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në matjen e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi pendimin për veprën e kryer dhe kërkim faljen ndaj palës së dëmtuar, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do ta shqetësojë të dëmtuarën dhe nuk do të përsërit më sjellje të tilla, e rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa rrethana rënduese gjykata në rastin konkret nuk gjeti. Andaj, gjykata marrë parasysh rrethanat e lartcekura të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në masën e ndalimit në rast të revokimit të dënimit me kusht, gjykata e mori konform nenit 79 të KPRK-së.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën par 3.1 të Ligjit numër 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike u bazua në nenin 460 të KPPK-së, pasi që e dëmtuara në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se heqë dorë nga kjo e drejtë.

Të pandehurit D. H., gjykata me aktvendim të veçantë P.nr.316/24 të datës 23.09.2024, i ka ndërprerë masën e ndalimit për t'iu ofruar vendit dhe personit të caktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN.**

**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**

**P.nr.316/24, me datën 18.10.2024.**

**Bashkëpunëtori profesional  
Visar Zeqiri**

**GJYQTARJA  
Benita Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjyk